



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETARI

Nr. 1884/Prot

Shkodër, më 20.01.2024

Lënda: Dërgohet për shqyrtim relacioni dhe projekt-vendim "Për një ndryshim në VKB nr.55, datë 29.12.2023, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër", të ndryshuar;

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin: "Për një ndryshim në VKB nr. 55, datë 29.12.2023, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër", të ndryshuar;

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR
Benet BECI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETARI

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ .2024

Për një ndryshim në VKB nr. 55, datë 29.12.2023, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër", të ndryshuar;

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ .2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 54 shkronja "dh", ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar; ligjit nr. 68/2017 "Për financat vendore", i ndryshuar; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar; ligjit nr.10296, datë 8.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar; ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil" të ndryshuar; ligji 7961, datë 12.07.1995 'Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë' të ndryshuar, ligji nr. 69/2012, "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligji nr.10352, datë 18.11.2010 "Për Artin dhe Kulturën", i ndryshuar, VKB nr. 55, datë 29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër", të ndryshuar, si dhe relacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë.

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin në numrit total të punonjësve të bashkisë Shkodër, sipas tabelës nr.11, pjesë përbërese e këtij vendimi.
2. Fondi i pagave për punonjesit shtesë të bashkisë Shkodër përballohet nga buxheti i bashkisë viti 2024.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Benet BECI

ZV/KRYETAR



1

Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve
Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

Donis Veseli

Drejtori Juridike

B. Ljepo

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe
Shërbimeve mbështetëse

Andrita Gergjeli

Drejtoria e Kulturës

Sandra Smajaj

Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike

A. Sahiti

Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit
Financiar

Enxheta

Enxheta

Drejtoria e Arsimit

P. Rudinovski

P. Rudinovski

Drejtoria e Përgjithshme e Mirembajtjes së
Objekteve Publike

Glazda

Ishte
NUMRI I PUNONJËSVE- Viti 2024


Tabela Nr. 11

Institucioni	Kodi institucionit	Numri i punonjësve të miratuar	Numri i punonjësve me kontratë
Bashkia Shkodër	2141001	603	20
Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike	2141044	126	
Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	2141045	228	
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit	2141042	42	
TOTALI- (Efektet financiare me fondet e veta)		999	20
Gjendje Civile - Efektet financiare me transfertë të kushtëzuar)	2141001	20	
TOTALI		1019	20

Bëhet
NUMRI I PUNONJËSVE- Viti 2024

Tabela Nr. 11

Institucioni	Kodi institucionit	Numri i punonjësve të miratuar	Numri i punonjësve me kontratë
Bashkia Shkodër	2141001	618	20
Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike	2141044	141	
Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	2141045	238	
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit	2141042	42	
TOTALI- (Efektet financiare me fondet e veta)		1039	20
Gjendje Civile - Efektet financiare me transfertë të kushtëzuar)	2141001	20	
TOTALI		1,059	20





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KRYETARI

RELACION

Për një ndryshim në VKB nr. 55, datë 29.12.2023, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër", të ndryshuar;

Të nderuar këshilltarë,

Në mbështetje të nenit 54 shkronja "dh", ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar; ligjit nr. 68/2017 "Për financat vendore", i ndryshuar; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar; ligjit nr.10296, datë 8.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil" të ndryshuar; ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 'Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë' të ndryshuar, ligjit nr. 69/2012, "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr.10352, datë 18.11.2010 "Për Artin dhe Kulturën", i ndryshuar, VKB nr. 55, datë 29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër", të ndryshuar, si dhe relacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë; Bashkia Shkodër paraqet për shqyrtim relacion për:

1. Miratimin e rritjes së numrit të punonjësve në Drejtorinë së Arsimit, nga 212, që është aktualisht, në 222 punonjës.
2. Miratimin e rritjes së numrit të punonjësve në Drejtorinë e Përgjithshme të Kulturës dhe Sportit, nga 61 që është aktualisht në 66 punonjës.
3. Miratimin e rritjes së numrit të punonjësve në Ndërmarrjen e Shërbimeve dhe Punëve Publike, institucion në varësi të Bashkisë Shkodër nga 126 që është aktualisht në 141 punonjës.
4. Miratimin e rritjes së numrit të punonjësve në Drejtorinë e Përgjithshme të Mirëmbajtjes së Objekteve Publike, institucion në varësi të Bashkisë Shkodër nga 228 që është aktualisht në 238 punonjës.

Pra në total një rritje prej 40 punonjësish.

Kërkesa për rritjen e numrit të punonjësve tek Drejtoria e Arsimit vjen si rezultat i rritjes së numrit të regjistrimeve të fëmijëve në arsimin parashkollor për vitin shkollor 2024-2025, si dhe të një numri shumë më të lartë se viti paraardhës i regjistrimit dhe evidentimit të fëmijëve me aftësi ndryshe. Për këto fëmijë nevojitet ofrimi i një shërbimi profesional, shërbimi me drekë përkujdesja e veçantë për të gjithë fëmijët në kopshte dhe çerdhe.

Ne kemi 58 njësi (kopshte dhe çerdhe) që ofrojmë shërbime për 1985 fëmijë të grup moshës nga 0-6 vjeç, të ndara në : 44 kopshte pa drekë, 7 kopshte me drekë dhe 7 çerdhe.

Gjithashtu kjo shtesë në strukturën e kopshteve dhe çerdheve vjen edhe për faktin se janë marrë për bazë kërkesat e shumta të realizuara këtë vit në dëgjesat publike, kërkesa të sjella nga administratorët e njësisë administrative, administratorëve të lagjeve dhe kryetarëve të fshatrave për shërbime edukative ndaj fëmijëve 3-6 vjeç dhe fëmijëve në çerdhe.

Në këtë kuptim për të iu përgjigjur nevojave të qytetarëve për akses në shërbimet që ofron bashkia si dhe për të garantuar standardin e cilësinë e ofrimit të shërbimeve si dhe për të respektuar përcaktimet ligjore në fushën e arsimit nevojitet shtimi i strukturës së kopshteve dhe çerdheve; me 8 punonjës arsimore (edukator dhe edukator ndihmës) në kopshte dhe 2 kujdestar (në çerdhe), pra në total prej 10 punonjësish.

Kërkesa për rritjen e numrit të punonjësve tek Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit bazohet në faktin se një institucion i kulturës i cili ka një ndikim të madh në qytet për zhvillimin dhe nxitjen e jetës kulturore artistike është **Kinema Republika**. Tashmë është bërë një rikonstruksion pjesor të ambjenteve të kinemasë që është angazhuar të kontribuojë në pasurimin e jetës kulturore dhe artistike të qytetit tonë. Përveç rikonstruksionit, mirëmbajtjes së godinës dhe pajisjes me teknologji të standarteve të larta, për mbarëvajtjen dhe administrimin e institucionit është e nevojshme të rekrutohet një staf i specializuar.

Për të rijetesuar aktivitetin e kinemasë është e nevojshme që kinemaja të ketë një staf përgjegjës i cili do të funksionojë për bashkërendimin e të gjithë veprimtarisë së kinemasë.

Është e nevojshme që të bashkëpunohet me shumë aktorë si shkollat, kopshtet dhe institucionet e tjera me te cilat duhet te mbahet kontakt i vazhueshëm përmes promovimit dhe rritjes së vizualitetit të aktivitetve dhe veprimtarisë së kinemasë. Staf i do të jetë përgjegjës për marrëdhëniet me median dhe komunikimin publik, përdorimin e rrjeteve sociale, marketing dhe design, do të mbulojë pjesën teknike dhe administrative të aktiviteteve në kinema, do të koordinojë aktivitetet, do të hartojë dhe realizojë kalendarin e aktiviteteve që do të zhvillohen në kinema. Ky staf do të jetë i aftë të përdorë dhe të mirëmbajë projektionin lentet dhe sistemin audio/ foni, kërkesat për ndriçimin, muzikën dhe të gjitha efektet zanore të produksionit dhe të montojë kolonën zanore, si dhe të mbaje përgjegjësi për mirëmbajtjen, modernizimin dhe plotësimin e bazës teknike dhe materiale ndihmëse.

Sa më sipër, me qëllim që të sigurojmë dhe të rrisim standartet e shërbimit dhe mbarëvajtjen e vëprimitarisë së strukturave përbërëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Kulturës dhe Sportit parashtrojmë kërkesën për shtesë të personelit me 5 punonjës.

Kërkesa për rritjen e numrit të punonjësve tek Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike, institucion në varësi të Bashkisë Shkodër, mbështetet në eksperiencën e punës së krijuar nga funksionimi i Ndërmarrjes së Shërbimeve dhe Punëve Publike në fillim të vitit 2024, si dhe nga evidentimi i problematikave të shumta që po hasim here pas here. Mendojmë se për një performancë të mirë, për një zgjidhje imediate të problemeve dhe kërkesave që dalin duhet rritur numri i fuqisë punëtore.

Pas analizës së bërë, problematikave të evidentuara me qëllim përmbushjen e detyrave funksionale të NSHPP, lind nevoja për të pasur një rritje të numrit të punonjësve në punë me qëllim ofrimin e shërbimeve me një performancë më të lartë.

1. Në mënyrë të vazhdueshme kemi kërkesa nga Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit për zbatim urdhra ekzekutimi, si edhe çdo ditë dalim me Policinë Bashkiake për lirim të hapësirave publike si në qytet ashtu edhe në njësitë administrative.
2. Ne detyrën që kemi për mirëmbajtjen e infrastrukturës në rrugët rurale jemi të pambuluar me organike për realizimin e objektivave që i kemi vendosur vetes për standartin e mirëmbajtjes së rrugëve rurale. Gjithashtu ne si ndërmarrje kemi edhe disa mjete teknologjike dhe mjete të rënda si; rrull, asfaltshtruse dhe na duhen punëtorë të specializuar.
3. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse në strukturën e saj ka 3 roje, meqenëse shërbimi i ruajtjes së objektit ofrohet 24/7. Objekti i NSHPP-së përveç zhvillimit të veprimitarisë së administratës, shërben edhe si vendi ku qëndrojnë automjetet e punës si dhe magazina e materialeve të NSHPP, është e nevojshme rritja e numrit të rojeve për objektin.
4. Drejtoria e Shërbimeve dhe Monitorimit të Pastrimit pasi mbulon qytetin dhe të gjitha njësitë administrative për mirëmbajtjen e pastrimit të rrugëve dhe shesheve nga ferrat, barishtet, pemët si dhe mbetjet urbane që krijohen si hotspote nevojiten si shtesë të fuqisë punëtore.

Nga sa më sipër, kërkesa për rritjen e numrit të punonjësve është 15 punonjës dhe vjen si rezultat i nevojës për të ofruar shërbime dhe punë publike në çdo Njësi Administrative apo Lagje/Rajon të Bashkisë Shkodër, duke pasur parasysh shtrirjen gjeografike të Bashkisë Shkodër, për të siguruar shërbime dhe punë publike të standarteve të larta në interes të komunitetit dhe për të rritur performancën, kjo kërkesë kthehet në domosdoshmëri për rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve.

Kërkesa për rritjen e numrit të punonjësve tek Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objeteve Publike, vjen si rezultat i ofrimit të shërbimeve ndaj interesit publik në territorin e juridiksionit të Bashkisë Shkodër, në mënyrë më të mirë të mundshme dhe në kohën e duhur për të realizuar në këtë mënyrë edhe qëllimin për të cilin DPMOP është krijuar.

Fokusi i drejtorisë konsiston në shërbime të interesit publik, administrimin, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e objekteve publike, duke kontribuar në rritjen e masave të cilësisë dhe sigurisë së tyre.

Investimet për mirëmbajtjen e objekteve të arsimit shkollor, parashkollor, qendrave shëndetësore, qendrave sociale, fusha dhe ambiente sportive, kinema, muze, bibliotekë etj. kërkojnë punonjës të kualifikuar në ndërtim, sistem elektrik, sistem hidraulik, hidro-sanitare, në mobilim etj.

Aktualisht numri i punonjësve të mirëmbajtjes është i pamjaftueshëm për kryerjen e shërbimeve të mësipërme, prandaj është e domosdoshme rritja e numrit prej 10 punonjësish të kualifikuar në specialitete të ndryshme për rritjen e performancës së punës së DPMOP-së, për mirëmbajtjen e objekteve publike arsimore, kulturore e sportive (shkolla, kopshte, çerdheve, teatër, ambjete sportive, kinema) për funksionimin me kushte bashkëkohore, me qëllim realizimin e çdo detyre në mënyrën më të mirë të mundshme.

Sa më sipër, i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë projekt vendimin paraqitur;

~~Për një ndryshim në VKB nr. 55, datë 29.12.2023, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër", të ndryshuar;~~

Duke ju falenderuar!

